



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5095/2022
Data:08.07.2022

PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e gjashtë -VI- për vitin 2022 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 21.06.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Sevdi Dernjani** (Nënkryetari i Komunës), **Nexhmedin Daci** (Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Kimete Kuka –Hasallari** (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2023-2025.
3. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2023.
4. Propozim vendimi për zgjatjen e afatit kohor për hartimin e Planit Zhvillimorë Komunal të Hanit të Elezit (PZHK-s).
5. Propozim vendimi për zgjatjen e afatit kohor për hartimin e Hartës Zonale të Komunës (HZK).
6. Kërkesa e z.Latif Berisha për ndërrim destinimin e pronës.
7. Kërkesa e z.Sherif Lusnjani për ndërrim destinimin e pronës.
8. Raport nga tubimi për përzgjedhjen e këshillave lokale të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane në territorin e komunës së Hanit të Elezit.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Korniza afatmesme buxhetore 2023-2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- korniza afatmesme buxhetore është përgatitur duke u bazuar në qarkoren buxhetore të cilën e ka dërguar Ministria e Financave. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Refet Kalisi thekson:- te të hyrat vetanake ishte një rritje e madhe si mendohet me u ngrit ato të hyra për shkak se është problem inkasimi i mjeteve.

Lindita Ballazhi thekson:- kjo është përcaktuar në bazë të tendencës së hyrave sepse edhe në vitin 2021 shuma ka qenë më e madhe për vitin 2022 . Kjo është qarkorja e parë dhe kemi bërë kërkesë për me i zvogëluar.

Nora Xhoni thekson:- në objektiva të cilat i keni planifikuar a është paraparë buxhetimi gjinorë .

Lindita Ballazhi thekson:- kjo është një aneks i qarkores buxhetore për objektivat katër vjeçare.

Refet Kalisi thekson:- i lexova prioritet dhe mu dukën bukur shumë dhe nëse keni menduar për një mandat është pak e vështirë. Është mirë me i marr tri apo katër objektiva dhe me i realizuar. Në kornizë është hequr ndërtimi i stacionit të autobusëve.

Mehmet Ballazhi thekson:- janë objektivat e mia si kryetarë i komunës që mendojë me i realizuar si kryetarë i komunës dhe nuk kemi dhanë garanca por ne kemi me bërë maksimumin që koto objektiva me i arritur dhe po që e shikoni kornizën buxhetore e kemi reduktuar.

Lindita Ballazhi thekson:- është hequr si projekt kapital për shkak se komuna nuk ka kompetencë absolute për me ndërtuar një stacion të autobusëve. Projektin e ka hequr Ministria e Financave sepse ligjërisht nuk kemi drejtë për shkak se duhet të formohet një ndërmarrje publike.

Sherif Berisha thekson:- unë mendojë se kjo kornizë buxhetore 2023-2025 është kopi pastë e qeverive të kaluara dhe nuk kam mundur me vërejt ndryshime të mëdha. Rritjet në buxhet janë gati se të njëjta dhe dallojnë shumë pak . Janë paraparë kupëzat e betonit që mendoj se jena lodhë me kupëza por edhe bashkëpunim nuk e shohë të duhur që ne jemi te kërkuar tek ju. Gjysma e viti shkojë dhe çfarë projekti kapital jeni duke bërë .

Mehmet Ballazhi thekson:- kjo kornizë është hartuar duke u bazuar në qarkoren buxhetore të cilën e ka dërguar Ministria e Financave dhe po ta shikoni materialin nuk është kopi pastë. Rregullimi i rrugëve me kupëza betoni është e domosdoshme për shkak se kemi kërkesa prej qytetarëve. Nëse keni ndonjë sugjerim edhe ju si opozitë mund ta parashtroni në mënyrë që të bëhen një planifikim më i mirë. Projekti kapital është shtëpia e kulturës, çështja e ujit për Hanin e Elezit, çështja e ujit në fshatin Gorancë , parku i qytetit. Me gjithë shantazhet dhe sabotazhet për katër muaj i kemi hartuar dhjetë projekte.

Lindita Ballazhi thekson:- kjo qarkore nuk është kopi pastë sepse deri te pjesa e objektivave është format i cili vjen prej Ministrisë dhe te pjesa e cila na lejohet me ndërhyjë kemi ndërhyjë duke filluar te përqindjet , te granti i arsimit kemi ulje nuk është sikur në vitin aktual , te granti specifik i shëndetësisë , te granti i përgjithshëm kemi ngritje.

Nexhmedin Daci thekson:- lista e projekteve është miratuar vitin e kaluar dhe i kemi parashikuar me i realizuar këta projekte dhe gjasat për me i ndërruar mund të themi se janë zero. Te shtëpia e kulturës në këtë fazë janë investuar 270 000 € . Është hartuar projekti i parkut të qytetit por për me fituar grantin prej Qeverisë dhe kanë kërkuar projekt detal dhe është dashur me angazhuar ekspertë të jashtëm për me bërë përsëri projektin dhe projekti është në tender dhe ju e dini sa kohë marrin procedurat e tenderimit. Është shpall tenderi për rregullimin e hapësirave përreth objektit të komunës . Së bashku me komunën e Kaçanikut kemi konkurrua në Ministri të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe në Uenhabitat për projektin shtegu për çiklist nga Uji i Thartë deri në Kaçanik por varte se a do ta përzgjedhin këtë projekt. Së bashku me komunën e Tearcës do të konkurojmë në projektet e IPA fondet. Te ambasada e Japonisë kemi konkurruar me një projekt për te Ura e Seçishtës. Për projektin e rrugicave i kemi pasur votë 40 000 € mjete financiare të komunës dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal i ka ndarë edhe 30 000 € dhe në këto ditë do të shpallet tenderi. Kemi hartuar projekt për muret mbrojtëse . Është hartuar projekti për rrugën Gorancë –Krivenik me të cilin do të aplikojmë në Ministri të Linjës për me naj financuar për shkak se nuk mundemi me buxhet të komunës.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim ; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA KORNIZA AFAT MESME BUXHETORE 2023-2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- unë mendojë që pjesë e komisionit të jenë anëtarët e komitetit për politik e financa dhe nëse e shihni të arsyeshme mund edhe ekzekutivi ta propozon ndonjë anëtarë komisioni. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim ; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITINN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Propozim vendimi për zgjatjen e afatit kohor për hartimin e Planit Zhvillimorë Komunal të Hanit të Elezit (PZHK-s).

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- kërkoj sqarim se pse po kurohet të vazhdohet afati.

Nexhmedin Daci thekson:- plani zhvillimorë komunal është dokument bazik në komunë dhe të gjitha planet të cilat bëhen në komunë duhet të jenë në pajtim me planin zhvillimorë komunalë. Planin zhvillimorë nuk është përfunduar me kohë për shkak të pandemisë , mirëpo tash dokumenti është gati dhe janë disa procedura të tjera që duhet të del në diskutim publik , duhet të konsultohemi me ministrinë se a është plani zhvillimorë në harmoni me planin hapësinorë të Kosovës.

Refet Kalisi thekson:- unë jam që t'i zgjatet afati por jam i zhgënjyer se pse nuk e kemi kryer ne si ish qeverisje për shkak se na kanë zhgënjyer edhe ata persona të cilët i kemi përzgjedhur për me kryer.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR ZGJATJEN E AFATIT KOHORË PËR HARTIMI E PLANIT ZHVILLIMORË KOMUNAL TË HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Propozim vendimi për zgjatjen e afatit kohor për hartimin e Hartës Zonale të Komunës (HZK).

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni vërejtje apo sugjerim mund ta parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR ZGJATJEN E AFATIT KOHORË PËR PËR HARTIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Kërkesa e z.Latif Berisha për ndërrim destinimin e pronës.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA KËRKESA E LATIF BERISHA PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Kërkesa e z.Sherif Lusnjani për ndërrim destinimin e pronës.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA KËRKESA E SHERIF LUSNJANI PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Raport nga tubimi për përzgjedhjen e këshillave lokale të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane në territorin e komunës së Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- në bazë të rregullores për organizimin e këshillave të fshatrave komisioni i cili ka bërë përzgjedhjen e këshillave të fshatrave duhet t'i raportojë kuvendit të komunës. Kryetarë i këshillit për fshatin Paldenicë, Dermjak, Neçafç, Vërtomicë është zgjedhur z.Sadam Dernjani. Kryetarë i këshillit për fshatin Seçishtë dhe Krivenik u zgjodh z.Mevludin Kuka . Kryetarë i këshillit për fshatin Gorancë dhe Rezhancë u zgjodh z. Shefket Lusnjani. Kryetarë i këshillit të Hanit të Elezit, Uji i Thartë, Lagjja e Re, Laç, Pustenik, Dimcë u zgjodh z. Mirsad Qajani.

Sherif Berisha thekson:- te zgjedhja e këshillit të Hanit të Elezit ka pasur vërejtje nga qytetarët se pse me u zgjedh personi nga Lagja e Re edhe pse e di që informimi ka qenë në nivel por arsyeje se pse nuk ka pasur prezencë nuk e di.

Natyrja Kalisi thekson:- informimi është bërë me kohë por nuk kemi mundur me ja imponuar qytetarëve që pa tjetër me marr pjesë. Ftesa ka qenë publike dhe me afat kohorë por pjesëmarrja ka qenë pak e ulët dhe në Han të Elezit është zgjedhur personi që ka marr më së shumti vota.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- në pyetjen të cilën e kam parashtruar më është dhënë përgjigjja se ekzekutivi i ri ka filluar punën me datë 01.12.2021 dhe është potencuar se nuk ka dhënë asnjë pëlqim për gurëthyes , mirëpo është mirë me na sqaruar pak më shumë për këtë çështje.

Nexhmedin Daci thekson:- në këtë mandat nuk është dhënë asnjë pëlqim për shkak se nuk është regjistruar asnjë kërkesë . Dhënia e pëlqimeve për miniera dhe minerale rregullohet me ligjin 03/L-163 të vitit 2010 , Ligjit për Miniera dhe Minerale dhe Ligjin me numër 04/L-258 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për miniera dhe minerale. Dhënia e pëlqimit komunal më saktësisht është e rregulluar me rregulloren 04/2011 për trajtimin e komunitetit në sektorin minerarë neni 3 pika 1 dhe pika 1.1. Pra me këtë rregullore precizohet që komuna jep pëlqim komunal dhe shtrohet pyetja se kush e lëshon këtë pëlqim. Në vitin 2019 komisioni për miniera dhe minerale ju kanë dërguar shkresë të gjitha komunave që pëlqimin duhet ta jep drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit hapësinorë.

Kryesuesi thekson:- unë nuk jam që askujt mos me ja ndaluar i cili donë me punuar por vetë jam që të zhvillohen procedurat ligjore që të merret edhe mendimi i komunitetit në mënyrë që edhe komuniteti të jetë i kënaqur. Këtu tu është bërë pyetje se a i ke dhënë pronë më shumë.

Nexhmedin Daci thekson:- komisioni për miniera dhe minerale i jep leje për licencë dallon prona dhe pëlqimi.

Refet Kalisi thekson:- në kuvend kur ju ka dhënë pëlqimi prezent ka qenë z.Xhemal Dernjani dhe ka premtuar se nëse ipet licenca për me punuar gurin në atë pjesë ka premtuar se do të punësohen tridhjetë punëtorë dhe nëse keni mundësi edhe ju si kryetar me nxjerr diçka për atë komunitet.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpallim të mbyllur mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:16.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi

